



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. _____	Br. Prot. _____
Dep. <u>DPK1</u>	Pro. No. <u>03-02/155/17</u>
Nr. I faq. _____	Data _____
Broj stranica _____	Datum <u>25.01.2017</u>
Nr. pages _____	Data _____
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4689-16, për Zyrtarin e lartë z.Shahin Nimani-Drejtor i Bordit të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave (KRM) "Ambienti" në Pejë, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt i interesi në ushtrimin e funksionit publik, nën dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-4689/16, për Zyrtarin e lartë, z.Shahin Nimani-Drejtor i Bordit të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave (KRM) "Ambienti" në Pejë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në dy biznese private është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Nimani (DPK-03-02-4777-16), dhe pastaj ai është paraqitur te ne në Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Nimani është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar ndryshimet në biznes (DPK/Dpki-03-02/10/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se, z.Nimani tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar në biznese private, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.




II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shaip Havolli /

